



Deklaratë për shtyp

ADRIPASS

Integrimi i lidhjeve multimodale në Rajonin Adriatiko - Jonian

Durrës

23.04.2019, 11:00

Në ambjentet e Autoritetit Portual Durrës u zhvillua takimi i parë me grupet e interesit në kuadër të projektit ADRIPASS.

Drejtori i Drejtorisë Teknike të APD-së, Drejtori i Doganës Durrës, Administratorja e DCT, përfaqësues të Drejtorisë së Hekurudhës si dhe stafi zbatues i projektit diskutuan për realizimin e një sistemi të përbashkët ICT.

APD është partner në projektin ADRIPASS dhe do të udhëheqë studimin për realizimin e planit pilot i cili do të rikonceptojë mënyrën e bashkëpunimit mes aktorëve që operojnë brenda komunitetit Portual.

Realizimi i këtij sistemi të integruar nënkupton bashkëpunim mes aktorëve në standarte europiane, zhvillim tregëtar më të lartë dhe bashkëpunim mes vendeve të zonës ADRION.

Studimi pritet të përfundojë në muajt Korrik – Gusht dhe do u prezantohet grupeve të interesit dhe publikut të gjerë në një konferencë që do të organizohet posaçërisht për projektin ADRIPASS.



Personi i kontaktit:

Fationa Muhametaj

Adresa: L. 1 Rr "Tregtare" Durrës, Albania

e-mail: f.muhametaj@apdurrës.com.al

Tel. nr.: +355 52 293 430

Website-i i projektit: <https://adripass.adrioninterreg.eu/>

Llogaritë në mediat sociale: <https://www.linkedin.com/company/adripass-euproject>

facebook: Adripass EuProject